



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

00 Numër: 71/2024
Data: 22.05.2024



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e 27-të të rregullt të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet më: **31.05.2024, e Premte**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2024 - 2026;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpallje në ankand publik të pronave bujqësore;
5. Njoftimi me Raportin vjetor të punës së prokurimit për vitin 2023;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për ndryshim të Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba nga drejtoria për Bujqësi;
7. Formimi i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave;

Kryesuesi i Kuvendit

z. Enver Rugova



Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e njëzet e gjashtë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **30.04.2024**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 15. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 16. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 6. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 7. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 8. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 22. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 9. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Arian Shatri VV;</u> |
| 10. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 11. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 25. <u>Andi Xhuraj PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 26. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj AAK;</u> | 27. <u>Melis Smakic;</u> |
| 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Nënkryetari i komunës Ali Nimanaj, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në

<https://www.youtube.com/watch?v=mDsQZlHqGEA>

: "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit– përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.
Hap punimet për mbledhjen e njëzet e gjashtë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezent janë 27 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar-Mars) të vitit 2024.
4. Marrja e Vendimit për tejkalimin e planit e të hyrave për vitin 2023 dhe të barten në vitin 2024.
5. Marrja e vendimit për rialokimin dhe transferin e mjeteve në kategoritë ekonomike shpenzime kapitale për vitin 2024.
6. Plotësimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba sipas rekomandimit të ministrive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit- para se ta propozojmë rendin e ditës e kemi të pranishëm tani me thënë përcjellësin e të gjitha mbledhjeve me dekada në komunën e Istogut, që më rastin e pensionimit të z. Hysen Pelaj përfaqësues i OSBE-së e kisha ftuar që t'i drejtohet Kuvendit.

Hysen Pelaj- përshëndet të gjithë dhe ju drejtohet Kuvendit me disa fjalë me rastin e pensionimit, dhe falënderon të gjithë për bashkëpunimin.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë Hysen!

A ka dikush diçka në lidhje me rendin e ditës? Pyes këshilltarët dhe ekzekutivin a kanë diçka lidhur me rendin e ditës?

Arben Kabashi-përshëndet të gjithë të pranishmit! E kam një propozim, ndoshta me vonesë por e kemi pasur një bashkëpunim për hartimin e Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026 me organizatën UN Women, materialin nuk kemi mundur të ja u përcjellim me kohë por ideja është që të kaloj sot për dëgjim publik, materialin do ta keni me kohë pasi të kalojnë procedurat tjera.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka? Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! E keni ndryshuar prapë rendin e ditës në mënyrë arbitrare. I keni larguar prapë ato dy pika që janë shumë të rëndësishme për komunën e Istogut të diskutohen. Pronat bujqësore, dhe pasuritë e paluajtshme të komunës së Istogut, banesat dhe lokalet afariste, në muajin nëntor 2023 i kemi votuar këto në mënyrë unanime, pra e kemi votuar Planin e Punës, gjithashtu edhe në nëntor 2022 po ashtu e kemi votuar, vitin e kaluar kemi diskutuar disa herë për këto punë, keni premtuar që këtë vit nuk ka me pasur censurë në Planin e Punës së Kuvendit, prapë ka censurë prapë nuk diskutohet për pasurinë e komunës së Istogut, e dimë që vlera e tokave bujqësore afërsisht 700 hektarë është 84 milionë euro, ndërsa komuna e Istogut nuk përfiton asnjë cent. Pastaj i kemi edhe disa banesa dhe lokale afariste edhe ato i shfrytëzon dikush, e pasi ju nuk po dëshironi të flisni, po dihet që shfrytëzohen nga militantët e juaj. Nuk e di ku po duam të dalim kështu z. Kryesues. Çdo herë po na premtoni që keni me i futur në rend dite, kemi me diskutuar, dhe ata bujqë që i shfrytëzojnë tokat, nuk janë të gjithë bujqë, disa i kanë vetëm prona të uzurpuara me na 100 hektarë, dha ja u shesin bujqëve me pare. Vitin e kaluar i keni kërkuar ja u kam dhënë emrat jashtë kamerave, ju i dini më mirë se unë, se po i lejoni vet. Nuk e di se çfarë po mendoni të bëni me këtë punë, në vend se me e përfituar edhe ata që i shfrytëzojnë, ata bujqë i pagujnë dikujt pare, kanë mundur të ja paguajnë komunës së Istogut dhe kishte përfituar komuna, pastaj e kishin pasur kontratën për shfrytëzim, kishin mundur të përfitojnë edhe subvencione, pastaj kishte mundur të planifikohet se çfarë të kultivohet, por çdo moment presin që komuna e Istogut t'i thërret mendjes e me i marrë në pronësi tokat e veta e me ju thënë atyre që po i shesin tokat mjaft më. Ju nuk po dëshironi të diskutoni për këto prona, po na ofendoni neve si votues të atij Plani të Punës, e po i ofendoni të gjithë votuesit tonë. Ne jemi të detyruar si Lëvizje Vetëvendosje mos me marrë pjesë në këtë mbledhje, dhe i ftojme kolegët tjerë që mos të lejojmë që të na ofendojnë më. Nëse nuk janë të gatshëm ekzekutivi për dy vite deri kur duhet të presim? Nuk nuk do të jemi pjesë e kësaj mbledhje, sot po largohemi ne, nëse vazhdoni të na pengoni do t'i shfrytëzojmë të gjitha mjetet demokratike që mbledhjen tjetër mos me e mbajtur as ju. I ftoj të gjithë mos ta mbajnë mbledhjen e sidomos kolegët nga opozita të AAK-së. Faleminderit.

Anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje lëshojnë mbledhjen në ora 10:30.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Kam qenë pjesë e grupit kur është hartuar Plani i Punës së Kuvendit 2024, na ke premtuar që në pjesën e parë të vitit do të jetë ajo për shqyrtimin e pronave të komunës dhe nuk ka ardhur, a bën me e ditur arsyen pse? Edhe një pikë të rendit të ditës që e keni hequr dy seanca me radhë dhe pika e fundit që ka qenë pyetje nga anëtarët e Kuvendit pse është hequr? Faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit- mua së pari po më vjen keq që nuk ma dha rastin kolegu ynë që të ja kthej një përgjigje. Negjdet me 31.12.2023 Kuvendi mbledhjen e fundit e ka bërë një shpallje publike prej 54 pronave ku i përfshinë rreth 520 hektarë tokë Florini mirë e tha. Por unë tani do e thirri një drejtor përkatës le të thotë a ka aplikacione ndaj atyre pronave, Kuvendi ma nuk ka çfarë të bëj, për imtësira tjera është fakt që nuk e kemi qitur si pikë të rendit të ditës. Sa i përket pyetjes së dytë, për pyetje dhe përgjigje Ligji për Vetëqeverisje Lokale nuk e parasheh, edhe në një mbledhje me kryesues të Kuvendeve që e kemi mbajtur në Asociacionin e Komunave u diskutua pse po e qesin këtë pikë ku nuk parashihet me ligj. Neni 47 pika 2 dhe 3 i Ligjit, neni 20 dhe 21 i Rregullores për Punë të Kuvendit që rrjedh nga po ky ligj për Vetëqeverisje Lokale saktë e rregullojnë këtë. Çdo këshilltarë ka të drejtë të bëj pyetje, ka të drejtë të kërkoj pika të rendit të ditës, por vetëm nëse kanë interes urgjent ose të përgjithshëm. Rreth kësaj dërgon kryesuesit të Kuvendit brenda 15 ditëve jam i detyruar me ja u kthyer me shkrim. Është më e fortë se ajo që bëni pyetje këtu pa i neglizhuar dhe injoruar përgjigjet nga kryetari dhe ekzekutivi. Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- ne kemi kërkesa shumë prej qytetarëve, me i shqyrtuar në seancë, p.sh unë sot kam diçka për të diskutuar me turizimin, pikë të rendit të ditës nuk ka për turizmin, nëse gjatë seance unë flas dal prej temës e ajo që ka qenë si pikë e rendit të ditës ka qenë e mirë se aty kemi mundur të parashtrojmë kërkesat e banorëve.

Kryesuesi i Kuvendit- Negjdet, më mirë është me e dhënë te kryesuesi me shkrim, dhe unë interesohem te kompetentët me ta jap me shkrim, kur ta kesh me shkrim dhe email është pak më ndryshe, se fjalët nganjëherë i merr edhe era se ke qenë aktiv në atë pikë të rendit të ditës, por tu kisha lutur me ju përmbajtur kësaj, e thashë krejt çka është me Ligj për Vetëqeverisje Lokale dhe me Rregullore të Punës së Kuvendit.

Negjdet Ramaj- p.sh unë e kam një pyetje për drejtorin e Zhvillimit Ekonomik, bjeshkët tona po degradohen e ne më së shumti jemi thirrur në turizmin malor, zhvillimi ekonomik nuk e ka paraparë një inspektor që del në terren dhe i ndalon ndërtime e egra, po detyrohem si banorë që me i marrë punët vetë në dorë me i larguar njerëzit mos me bërë ndërtime të egra. Edhe këto punë munden të dalin jashtë kontrollit liqeni i Moknës është në harta për zhvillim ekonomik vizitohet nga shumë banorë, aty e ka ndërtuar një villë dikush, nuk mundesh me u afruar se ajo është pronë publike por është përvetësuar nga njerëz të pandërgjegjshëm, nëse diskutojmë ne pa atë pikë të rendit të ditës po dalim jashtë temës rregullisht, por ju siç e shihni të arsyeshme mundeni me vazhduar.

Kryesuesi i Kuvendit- Negjdet bëre mirë që e përmende atë. Pronë e Agjencionit Pyjor të Kosovës edhe rojet që kanë qenë në kuadër të komunës i kanë marrë. Më nuk kemi qasje as në roje. Ligjin e ka miratuar Parlamenti i Kosovës, për dhënien e tokave në Agjencionin Pyjor, e ka qit ankandin gjashtë muaj, prej komunës, kanë konkuruar

njerëzit, a është pyetur komuna, vetëm pëlqim kanë marrë, janë duke u centralizuar gjërat. Për të gjitha mund të më drejtohesh dhe ti kthej përgjigjet me shkrim, jo vetëm ty por të gjithëve. Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Është e vërtetë që është pikë e rëndësishme e rendit të ditës rreth tokave bujqësore, dhe është e vërtetë që është viti dytë që po kërkojmë me qenë pikë e rendit të ditës. Në mbledhjen e fundit të vitit është diskutuar për ato 54 prona, por nuk është vetëm interes i atyre që diskutojnë, por identifikimi i këtyre pronave dhe shfrytëzuesve të tyre është e rëndësishme të dihen se sa në mënyrë ligjore i shfrytëzojmë këto prona dhe sa përfiton komuna buxhet prej tyre. Të caktohet një komision të dalë dikush në terren të identifikohen pronat nga kush po shfrytëzohen. Pra duhet të futet kjo pikë në rend dite dhe të diskutohet se nuk është pak e rëndësishme. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Një sqarim sa i përket këtyre pronave, ajo çfarë duhet të dinë edhe qytetarët që na ndjekin është që ky ekzekutiv nuk ka dhënë asnjë pronë në shfrytëzim gjatë këtij mandati. Ju e dini që i kemi votuar dy herë në fund të vitit ashtu siç e kërkon ligji, listen e pronave të veçanta që planifikohen të jepen në shfrytëzim për vitin e ardhshëm vazhdimisht e kemi votuar atë listë këtu edhe listën e përgjithshme, kemi tentuar me bërë edhe komision për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave siç jeni në dijeni, kur e kemi formuar komisionin e vlerësimit dhe të ankesave, komisionin e ankesave e cek ligji që është me mandat dy vjeçar na ka pranuar MAPL-ja, komisionin e vlerësimit e kanë kthyer pas për shkak se kanë kërkuar që për 54 prona me i formuar 54 komisione ka pesë anëtarë nga Kuvendi, është e palogjikshme, për njoftimin e juaj ky ligj është në plotësim-ndryshim, po pritet që të ketë lehtësime në këto procedura të dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave. Pa u miratuar ky ligj i ri, me ligjin e vjetër e kemi të pamundur. Të presim dhe të shohim.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- ne nuk duhet të tentojmë por duhet të veprojmë dhe me krijuar komisione nëse është nevoja edhe 100 komisione. E ato prona komunale me u evidentuar prej kujt janë të uzurpuara dhe me dalë emrat publikisht. Komuna nuk ka nevojë me i shitur pronat por qira mundet me marrë, neve na intereson komuna e Istogut si e ka të zgjidhur problemin e pronave, jo komunat tjera. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- siç e tha parafolësi neve na intereson numri i pronave të uzurpuara, identifikimi i tyre a janë 54 prona a janë ma shumë, ne e dimë që tokat nuk shiten, por jepen në shfrytëzim, qëllimi është ky të identifikohen numrat nga kush janë të

uzurpuara e pastaj të vazhdoen procedurat për dhënie në shfrytëzim e kështu me radhë. Më duket që ka prona më shumë për atë arsye kërkova komision që me dalë me i identifikuar sa janë saktë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Nuk e di pse nuk jemi duke ju përmbajtur rendit të ditës. Jemi duke diskutuar për një pikë që as nuk po hedhet në propozim si pikë e re e rendit të ditës e as nuk është si pikë e rendit të ditës. Nëse ka aq interesim hajde te hedhim në votim ose kalon ose nuk kalon. Por mos të humbim kohë me diçka që nuk është pjesë e rendit ditës. Ose unë tani po ja filloj të flas për bursa, edhe as nuk po e futi si propozim për pikë të rendit të ditës e as nuk është rend dite. Të shkojmë pak në bazë të Rregullores.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- kolegu Xhuraj, kjo çështje është që dy vite dhe nuk janë përpjekjet që me e fut tani ose më vonë, janë mendimet e të gjithëve që është pikë e rëndësishme, nuk e kemi në rend dite por është dashur të hyj në rend dite dhe nuk është interes personal i asnjë subjekti politik, kjo nuk duhet t'i pengoj askujt, nuk është diskutim palidhje mbetet te ekzekutivi kur do ta fus në rend dite.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- nëse kjo pika e rendit të ditës 'të tjera' që e kemi pasur deri sot, nuk futet në rend dite siç ka qenë, gjithmonë keni me e pasur kështu në mbledhje sepse ndryshe nuk ka mundësi se qytetarët duan ta dinë se çfarë po ndodhë. Dhe kur e kemi hartuar Planin e Punës së Kuvendit që kemi qenë këtu pa prezencë të kamerave, e kemi futur në rend dite që të vijë në prill ka qenë e shënuar decidivisht, mirë e kishte Florini, ne nuk duam ta lëshojmë seancën por premtimi është dashur të mbahet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- nuk kam asgjë kundër kësaj teme, i vetmi shqetësim i imi është, nëse duam të diskutojmë me e hedh në propozim kaq.

Kryesuesi i Kuvendit- e përmbyllim debatin. E hedh në votim propozimin e ekzekutivit për Shpallje në Diskutim të Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026 që të hyj në rend dite? Kush është për?

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të pranishëm të Kuvendit me 21 vota për 1 kundër dhe 0 abstenim kjo pikë votohet që të futet në rend dite.

Atëherë e hedh në votim rendin e ditës në terësi me pikën e propozuar, kush është që të miratohet rendi i ditës në terësi?

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 22 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendi i ditës për mbledhjen sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- sipas Listës së nënshkrimeve të gjithë anëtarët e Kuvendit kanë qenë prezent (para daljes nga mbledhja nga anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje).

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka dikush diçka në lidhje me dy procesverbalet nga mbledhjet e kaluara? Së pari e hapi debatin për procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e datës 19.03.2024 a ka dikush diçka? Pasi që jo e hedh në votim. Kush është për?

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme i datës 19.03.2024.

E hapi debatin për procesverbalin e mbledhjes së rregullt, të datës 29.03.2024 a ka dikush diçka? Pasi që jo e hedh në votim. Kush është për?

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverbali i mbledhjes së rregullt i datës 29.03.2024.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- fjala është për nënkryetarin e komunës.

Nënkryetari i komunës- ia kalon fjalën drejtorit Genc Ademaj.

Genc Ademaj- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton raportin financiar për tre mujorin e parë (Janar-Mars) të vitit 2024.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- një pyetje te dëmet nga vërshimet thatë që është shpenzuar 100% a ka mundësi listën me e pasur ne si anëtarë të Kuvendit me e ditë se kush ka përfituar. Faleminderit!

Genc Ademaj- po i nderuar lista ju bashkëngjitet mbledhjen e ardhshme, ashtu jemi dakorduar.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- mua më interesoi këtu te Bujqësi dhe Agroekonomi, ju e potencuat shumë mirë që pjesa e Pylltarisë në qershor do të hiqen nga pagat, tani mua më intereson këto 16 vende të lira, a është duke punuar kush apo çfarë është duke ndodhur, për vendet e tjera i pamë ju u arsyetuat që janë në procedurë të konkurseve, ajo çfarë desha më shumë të fokusohem është te çështja e vendeve të lira të auditimit, është konstatuar që duhet të çertifikohen ku e di unë çfarë, pra a duhet me marrë çertifikatë vetëm auditori kryesor i brendshëm apo edhe punëtorët e tij? A munden ata të punojnë pa u çertifikuar? Për arsim e kemi diskutuar disa herë, shpresoj që ato vende të lira të mos vonohen shumë procedurat. Faleminderit!

Genc Ademaj- sa i përket atyre 16 vendeve të lira tashmë ato janë vende të shuara, nuk kemi të drejtë të zhvillojmë procedura për to. Sa i përket Zyrës së Auditorit të Brendshëm, patjetër që punëtori i ri momentin që shpallet konkursi duhet të jetë i çertifikuar paraprakisht.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka kërkuar Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha një pyetje për drejtorin, lidhur me numrin e shtuar për momentin në arsim i kemi -4 vende a rrezikohet që këta persona të mbesin pa paga apo ka ndonjë procedurë me të cilën do ti marrin pagat.

Genc Ademaj- vitin e kaluar e kemi diskutuar i kemi pasur 85 vende në arsim prej tyre kemi arritur në numrin 5, por kjo është harmonizuar fatmirësisht por sistemi nuk e njeh shtimin në listën e pagave të punëtorëve me kontratë me afat të caktuar për shkak zëvendësimeve. Për këtë arsye na figuron numri më shumë.

Hajrush Shoshi- vitin e kaluar kur na ka ardhur Qarkorja Buxhetore ka ardhur që numri i mësimdhënësve reduktohet vetëm për 5 punëtorë kurse në Buxhet janë për 7 punëtorë të reduktuar ka qenë 649 tani është 642, mirëpo po e flas me përgjegjësi bukur të plotë për shunë vite me radhë numri 646 është ndër më të lartit sot që është të punësuar. Gjithmonë ka qenë nën 646 edhe përkundër asaj që po bie numri i nxënësve. Prandaj pjesa e 80 mësimdhënësve janë ashtu të paraparë me udhëzim administrativ që është në tërë Kosovën, mund të them që komuna e Istogut ka qenë e renditur me nxënës e shtata apo e teta në nivel të Kosovës. Ne kemi qenë shumë mirë. Prandaj ky numër ishte dashur që të korrigjohet.

Genc Ademaj- nëse kishte qenë mundësia që organizata buxhetore me e shtuar numrin e punëtorëve në arsim dhe shëndetësi sipas dëshirës së tyre jam i bindur që ai numër kishte me qenë i dyfishuar jo në komunën tonë po në të gjitha komunat tjera. Sqaron edhe më tutje.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor. A dëshiron edhe dikush të diskutoj rreth raportit financiar? Po konsideroj që u eksploruam e gjithë ajo çfarë patëm të themi. Ju faleminderit!

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj-prezanton pikën e rendit të ditës 'Marrja e Vendimit për tejkalimin e planit të të hyrave për vitin 2023 dhe të barten në vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Po e bëj një pyetje së pari unë, a keni të drejtë me këto mjete ligjërish projektë të reja.

Genc Ademaj- po e lejon. Me këto mjete rekomandohet që të jenë në kategorinë shpenzime kapitale dhe mos të shfrytëzohen për subvencione ose diçka tjetër sepse është e vetmja mundësi që mundet me u shfrytëzuar. Dhe fatmirësisht të gjitha i kemi në projekte kapitale që është një performancë shtesë në shpenzimin e tyre. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin. Fjalën e ka Arta Balaj.

Arta Balaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! A ka mundësi një sqarim drejtor këtu tek rialokimi i mjeteve shuma prej 2100 eurove që kanë mbetur nga kanalizimi i lagjes “Balaj” në fshatin Lluga, kjo shumë a kalon në ndonjë projekt të ri apo për pjesën tjetër të kanalizimit në fshatin Lluga dhe Llukafc të Begut, apo shpërndahen në ndonjë projekt tjetër. Edhe një pyetje tjetër pasi që nuk e kemi më pikën e rendit të ditës Pyetje nga anëtarët e Kuvendit, kur planifikohet të asfaltohet rruga te familja Buleshkaj në Istog të Poshtëm, duan ta dinë banorët. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- ju lutem mos të dalim nga rendi i ditës, Arta i drejtohesh kryesuesit me shkrim dhe drejtori nuk është i obliguar të ju përgjigjet. Jo vetëm ty por të gjithëve. Fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- te pjesa e kanalizimit vazhdon këtë vit dhe bartet në një projekt tjetër. Është tek pika tjetër e rendit të ditës Transfer dhe rialokim tani e elaborojmë atë. Sa i përket asfaltimit te rruga në Istog të Poshtëm planifikojmë që këtë vit ta realizojmë varësisht prej mjeteve që i kemi në dispozicion.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- një pyetje për drejtorin, a janë këto obligime nga viti 2023 të gjitha të futura në listën e borxheve apo ndonjë prej tyre është vazhdim i projektit edhe këtë vit.

Genc Ademaj- jo këto janë projekte që janë mbyllur, disa prej tyre këtë vit dhe disa prej tyre në përfundim të vitit të kaluar, nuk e lejon rregulli i shpenzimit të parasë pas datës 24 dhjetor, por edhe zotimin e tyre që është deri me 28 nëntor, pse barten këto është sepse janë projekte që nuk mundemi me i pranuar pa i siguruar mjetet.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Drejtori na dha sqarime, dhe po flas personalisht janë mjete shumë mirë të alokuara, e përgëzoj ekzekutivin.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha të lidhem te tema e palestrës që e përmendi drejtori, është në bashkëfinancim me ministrinë dhe e përmendi që janë tërhequr një pjesë nga përmbaruesi, desha një sqarim si keni vepruar a parashihet në atë afat të kontratës të përfundohet palestra, dhe një pyetje tjetër e kam te kjo pjesa e alokimit të mjeteve, e kam parë

një pjesë të lumi atje që e ka pasur të rregullimi i lumit që janë tërhequr edhe aty disa mjete desha ta di arsyen dhe si është vendosur prioriteti i mjeteve.

Genc Ademaj- përgjigjet në pyetje dhe jep sqarime.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- pjesën më të madhe e tha kolegu, ne e kemi diskutuar edhe në KPF se janë marrë nga kontrata kolektive i ka prek disa projekte fatkeqësisht edhe të palestrës edhe të pastrimi i lumit dhe të tregu i ri. Pak a shumë përgjigjen e morëm se si do të shpenzohen, por a do të mund të kompensohen sepse është bukur një shumë e madhe e të hollave për realizimin e këtyre projekteve, apo rrezikohet ndonjëri nga këto projekte që janë më të mëdha.

Genc Ademaj- profesoreshë fatmirësisht falë edhe mirëkuptimit nga ana juaj si Kuvend nuk e kemi pasur ndonjë telashe financiare të mos realizimi i pagesave nga ana e komunës. Deri tani kemi arritur ta bëjmë një menaxhim të duhur financiar, duke i ranguar prioritetet të cilat janë më urgjente, pavarësisht prej prekjes së padëshirueshme që na është bërë nga kontrata kolektive kemi arritur ta menaxhojmë jashtëzakonisht mirë. Për këtë arsye i kemi bërë transferet dhe rialokimet që do të kalojmë pastaj në pikën tjetër dhe do t'i lexojmë një nga një dhe të vazhdojmë tutje me realizimin e projekteve që veç janë të kontraktuara.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- kur thatë punë kryesi në sallën e sporteve i bën disa punë shtesë çka nuk janë marrë vesh, desha ta di a është punë shtesë një muri mbrojtës që ju ka marrë pjesës së palestrës që është dëmtuar infrastruktura e palestrës së sporteve, është duke u ndërtuar në fushën ndihmëse të futbollit, e desha me ditë a është punë shtesë që e ka bërë kompania apo komuna është duke i zhvilluar ato punime, se unë e di që Federata e Futbollit ka momerandum me komuna, jo vetëm me Istogun por me gjitha komunat për ndërtimin e fushave ndihmëse me bari artificial. Ajo fushë kur të ndërtohet a kanë ndonjë plan me ja u dhënë të gjitha klubeve në Istog apo prapë pronari i një biznesi në Istog që është aksionar në klubin e futbollit Istogu me 51% a do jetë ajo fushë vetëm për klubin e Istogut apo edhe për klubet tjera.

Genc Ademaj- Negjdet unë i kam dy përgjigje për pyetjen që ma bëre. E para jo nuk është punë shtesë se nuk ka të bëjë me palestren, e dyta është se muri mbrojtës është në kuadër të fushës ndihmëse që po e bën komuna me klubin e futbollit me federatën, që ma merr mendja është një nevojë urgjente për komunën e Istogut, ajo është në shfrytëzim të të gjitha klubeve të sportive, ashtu siç janë duke i shfrytëzuar të gjitha terrenet sportive të gjitha klubet, nëse një klub thotë që po i mohohet e drejta atëherë nuk është e vërtetë. E kam dëgjuar por nuk qëndron absolutisht.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka rreth kësaj pike? Pasi që jo, atëherë e hedh në votim, kush është që kjo pikë të miratohet?

Konstatohet që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet pika e rendit të ditës Marrja e Vendimit për tejkalimin e planit të të hyrave për vitin 2023 dhe të barten në vitin 2024.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- prezanton pikën e rendit të ditës 'Marrja e vendimit për rialokimin dhe transferin e mjeteve në kategoritë ekonomike shpenzime kapitale për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit-a ka dëshiron dikush të diskutoj lidhur me këtë pikë? Po konsideroj që jo, atëherë e hedh në votim, kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet pika e rendit të ditës Marrja e vendimit për rialokimin dhe transferin e mjeteve në kategoritë ekonomike shpenzime kapitale për vitin 2024.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- rekomandimet janë të qarta nga ministrinë përkatëse. Ata i kanë tarifat e veta unike në krejt Kosovën dhe na duhet me ju përmbajtur. Fjalën e ka drejtori Dukagjin Hoxhaj.

Dukagjin Hoxhaj- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton pikën e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- nuk e besoj se kemi çfarë të diskutojmë sepse këto janë vendime që kanë ardhur nga MAPL-ja, por e kam një vërejtje nga materiali që ka ardhur, po më çudit çfarë ka shkruar bujqësia këtu me stilolaps, janë bërë disa nënvizime që ka qenë e panevojshme. Mos na korrigjoni se duhet të lexohet komplet materiali dhe kur te lexojmë e marrim vesh. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit në vërejtje, njerëz jemi mund të gabojmë edhe ne. A ka edhe dikush të diskutoj rreth kësaj pike? Faruk Kabashi e ka kërkuar fjalën.

Faruk Kabashi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Pasi jemi te plotësimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha, këto ditë kam pasur një debat me një person që merret me sport, te drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale neni 9 pika 2.23 ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive për 1 orë 25 euro, klubet përkundër vështirësive financiare që kanë na ja u kemi bërë 25 euro 1 orë për ambulancën, unë kisha kërkuar që në qoftë se ka mundësi me u ndryshuar, mundemi me ja u hequr këto shpenzime, personalisht nuk e kam ditur që klubet i paguajnë vetë këto mjete. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Faruk po të japi të drejtë edhe unë ndoshta kisha qenë pro kësaj, por kjo është votuar dhe nuk mundet të kthehet më vjen keq. Vitin e ardhshëm kur të bëhet Rregullorja rrini gati jo vetëm kësaj po të gjithave, nuk them që është e përkryer ka defekte por për ata jemi ne këtu. Faleminderit! Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- e pata një pyetje sa i përket gjendjes civile atyre ju ka shkruar një Rregullore sa i përket lirimit për veteranët por familjarët e tyre nuk janë të cekur a ka mundësi kur kanë me

pasur atë Rregullore gjendja civile, isha një ditë aty dhe mora informacion që para janarit ju ka shkuar Rregullorja dhe nuk mundën me bërë ndryshime pa ju ardhur Rregullorja tjetër prej Kuvendit komunal.

Kryesuesi i Kuvendit- atyre nuk ju ka shkuar Rregullorja e dytë që është bërë plotësim-ndryshimi se atëherë me propozimin tënd është bërë ndryshimi dhe lirohen të gjithë plus e kemi bërë që edhe policia e Kosovës është në atë domen. Drejtori i Administratës e ka fjalën.

Arben Kabashi- ata e kanë rregulloren nuk ka nevojë të lëshohet vendim.

Negjdet Ramaj- unë isha vet aty dhe kam diskutuar me të gjithë punëtorët aty ata ma treguan një Rregullore që e kanë marrë diku në fund të muajit të dymbëdhjetë, këtu lirohen vetëm familjarët e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës dhe jo të veteranëve. Ata thanë nuk mundemi me vepruar pa e pasur Rregulloren e re dhe ishin duke pritur që me ju shkuar prej Kuvendi Rregullorja e re. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- tani më njoftoj sekretaria që me email ju ka shkuar Rregullorja, vendimi i Kuvendit duhet të zbatohet, do merrem personalisht me këtë do flas me shefin e sektorit atje. Faleminderit shumë! A ka edhe dikush diçka rreth kësaj pike? Kush është që të votohet ky plotësim i Rregullores me rekomandimet nga ministrinë përkatëse?

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet pika e rendit të ditës Plotësimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha sipas rekomandimit të ministrive përkatëse.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi diskutimin rreth kësaj pike? Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- kisha kërkuar nga ju që materialet të vijnë më herët se ne nuk jemi pengesë që mos të kalojnë në diskutim publik, por paraprakisht me e pasur materialin ndoshta kishim kontribuar secili prej nesh diçka, nuk jam për me e ndalur jam për me e vazhduar tutje, por materialet të na vijnë më herët. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- me të drejtë e ke Ajshe, me drejtorin jam dakorduar që kjo organizata UN Women nuk e ka përfunduar një pjesë të vet të rekomandimeve që e ka, sepse komisionin që e kanë themeluar në kuadër të Kuvendit komunal është pjesë edhe Valbone Demaj prej Grupit të Grave Asambleiste e ka kryer punën e vet. Kush është që kjo të shkoj në diskutim publik?

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet pika e rendit të ditës Shpallje në Diskutim të Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026.

Kryesuesi i Kuvendit

Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:42

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova**

+



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok – Municipality of Istog

PLANI LOKAL I VEPRIMIT
PËR
BARAZINË GJINORE

2024 - 2026

Maj 2024

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 – 2026 u përgatit nga Komuna Istog me mbështetjen e UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit “Gender Equality Facility” (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

Ekspertiza teknike nga UN Women / GEF:

Artan Binaku, Koordinator Projekti

Monika Kocaqi, Konsulente ndërkombëtare

DRAFT

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës, z. Ilir Ferati

Të nderuara/nderuar qytetare/qytetarë të Komunës së Istogut,

Me kënaqësinë time më lejoni t'ju prezantoj Planin tonë të Veprimit për Barazi Gjinore, plan i cili shërben si udhërrëfyes për veprimet e komunës tonë për nevojat e grave dhe burrave.

Para se gjithash, ky plan përfaqëson angazhimin tonë të palëkundur për arritjen e barazisë së vërtetë gjinore. Ky nuk është thjesht një dokument, por një katalizator për ndryshim, duke na fuqizuar për të krijuar një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

Një nga shtyllat kryesore të planit tonë është arsimi. Ne besojmë se arsimi është themeli i përparimit për ndryshim. Duke promovuar kurrikulat e ndjeshme gjinore dhe duke ofruar mundësi të barabarta në shkolla, ne duhet t'i fuqizojmë brezat e ardhshëm që të sfidojnë stereotipet gjinore dhe të respektojnë barazinë gjinore.

Një aspekt tjetër thelbësor i planit tonë është fuqizimi ekonomik. Ne e njohim rëndësinë e krijimit të një mjedisi ku gratë dhe burrat kanë akses të barabartë në punësim, sipërmarrje dhe fuqizim të drejtë. Nëpërmjet nismave të tilla si programet e mentorimit, mbështetjes financiare dhe politikat e vendit të punës që promovojnë ekuilibrin punë-jetë, ne mund të thyejmë barrierat që pengojnë përparimin drejt barazisë gjinore.

Për më tepër, plani ynë fokusohet në çrrënjosjen e dhunës me bazë gjinore dhe promovimin e sigurisë për të gjitha/gjithë dhe i gërsheton veprimet edhe me Planin Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje të cilin komuna jonë sapo e ka miratuar. Ne do të punojmë pa u ndalur për të forcuar sistemin e mbështetjes, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të siguruar burime për të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore. Duke nxitur një kulturë respekti dhe zero tolerancë ndaj dhunës, ne mund të krijojmë një shoqëri ku të gjitha/gjithë ndihen të sigurt/sigurt dhe të vlerësuar/vlerësuar.

Së fundi, plani ynë thekson rëndësinë e angazhimit të burrave dhe djemve si aleatë në përpjekjet për barazi gjinore. Ne besojmë fuqishëm se arritja e barazisë së vërtetë kërkon pjesëmarrjen aktive të të gjitha gjinive. Prandaj së bashku, ne mund të krijojmë një shoqëri më gjithëpërfshirëse.

Si përfundim, ky plan veprimi për barazinë gjinore nuk është thjesht një vizion, por një udhërrëfyes për ndryshim. Së bashku, le të fillojmë këtë rrugëtim, të bashkuar në angazhimin tonë për të krijuar një shoqëri ku të gjitha/gjithë, pavarësisht nga gjinia, mund të kontribuojmë.

Falënderim i veçantë për grupin punues dhe hartues të këtij dokumenti të rëndësishëm për komunën tonë si dhe për UN Women dhe Bashkimin Evropian për mbështetjen dhe asistencën profesionale përgjatë gjithë procesit të hartimit të këtij dokumenti.

Me respekt,

Ilir Ferati
Kryetar i Komunës së Istogut

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE	5
I. HYRJE	6
II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE	8
III. METODOLOGJIA	10
IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE	11
V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ 2024 - 2026.....	14
VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI.....	17
VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024-2026.....	19

DRAFT

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

ABGJ	Agjencia për Barazinë Gjinore
BDPFA	Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DAK	Drejtoria për Administratë Komunale
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DBHP	Drejtoria për Bujqësi, Hidroekonomi dhe Pylltari
DEMSH	Drejtoria për Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim
DEZH	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
DI	Drejtoria e Inspektionit
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
DKGJ	Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
DMS	Drejtoria për Mirëqenie Sociale
DSH	Drejtoria për Shëndetësi
DSHP	Drejtoria për Shërbime Publike
DPUM	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GGA	Grupi Jo Formal i Grave Asambleiste
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
KK	Komiteti për Komunitete
KPF	Komiteti për Politikë dhe Financa
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
ON	Organizatë Ndërkombëtare
PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore
PLVBGJ	Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SDG	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
SDNJK	Sektori për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete
ZBGJMD	Zyrtare/Zyrtar për Barazinë Gjinore dhe për Mbrojtje nga Diskriminimi
ZK	Zyra e Kryetarit

I. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 - 2026 u përgatit nga Komuna e Istogut, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore. të reflektuara në:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit.
- Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mos diskriminimi dhe fuqizimi i grave.
- Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.
- Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integritimit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

PLVBGJ u përgatit përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike lokale, organizatat e shoqërisë civile, Grupin Jo Formal të Grave Asambleiste, organizatat ndërkombëtare, Kuvendin Komunal dhe me zërat e banoreve dhe banorëve të Komunës së Istogut, të cilat / cilët patën mundësi të njihen dhe të japin komentet e tyre mbi këtë dokument përgjatë procesit të konsultimit publik. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit “Gender Equality Facility” (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).¹

Siç përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale², njësitë e vetëqeverisjes lokale janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve lokalë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave³, të reja dhe të rinjve⁴, vajzave dhe djemve.⁵

Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes lokale. Barazia gjinore prej vitesh është evidentuar si një çështje me përparësi në nivel vendi, e për këtë qëllim edhe në nivelin lokal është punuar e po punohet vazhdimisht. Në nivel vendi, në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, i cili bazohet në Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, jepen qartësisht fushat kryesore të ndërhyrjes, si dhe objektivat specifike për zbatimin e të cilave duhet të punojnë së bashku institucionet qendrore, lokale, OJQ-të dhe të gjithë partnerët lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë.

¹ Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: <https://eige.europa.eu/thesaurus/browse>

² Tekstin e Kartës mund ta gjeni në: <https://charter-equality.eu/the-charter/observatoire-europeen-en.html>

³ “Gra dhe burra” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 29 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).

⁴ “Të reja dhe të rinj” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 18 - 29 vjeç.

⁵ “Vajza dhe djem” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç.

Komuna e Istogut, në misionin e Sektorit për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete thekson rëndësinë e “...respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe reagimit për vënien e tyre në vend, sensibilizimit të banoreve e banorëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, **barazisë gjinore, të drejtave të fëmijëve, mundësisë të barabarta dhe mosdiskriminimit, të drejtave të komuniteteve, etj...**”. Pra barazia gjinore, mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi, janë fjalë kyçe në këtë deklaratë misioni dhe përbëjnë themelin e të gjithë ndërhyrjeve për mbrojtjen, respektimin, gëzimin e zbatimin e të drejtave të njeriut.

Në zbatim të kornizës ligjore e të politikave në fuqi në lidhje me çështjet e barazisë gjinore, si dhe në përputhje me misionin dhe vizionin e saj, Komuna e Istogut, ka emëruar një Zyrtare për Barazinë Gjinore dhe për Mbrojtje nga Diskriminimi (ZBGJMD). ZBGJMD në mënyrë të përvitshme harton dhe zbaton një plan të veprimeve konkrete për përparimin drejt barazisë gjinore. Ky plan e ka gjetur zbatimin me mbështetjen financiare nga komuna dhe donatorë, përmes partneriteteve e bashkëpunimit.

Megjithatë, pavarësisht përparimit të bërë në këtë drejtim në nivel vendor apo komunal, duhet të pranohet që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërhuara mbi bazën e stereotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikën, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror.

PLVBGJ 2024 – 2026 është konceptuar dhe lidhur pikërisht me kornizën ligjore dhe të politikave kombëtare, por mbështetet dhe merr frymëzim edhe nga dokumentet ndërkombëtarë të rëndësishëm, e synon të përafrohet me standardet dhe kërkesat e *acquis* të BE-së për barazinë gjinore. Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë plan, janë hartuar duke pasur parasysh faktin që asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve pra të të gjitha/gjithë anëtareve dhe anëtareve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithë përfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PLVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja “**në të gjithë diversitetin e tyre**”.⁶ Përmes saj theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave (por edhe burrave, të rinjve e djemve) në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë e të ndërthurur, për shkak të seksit, moshës, zonës ku jetojnë, etnisë, aftësive të kufizuara, nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, të qenit prind i vetëm, të qenit viktimë / e mbijetuar / i mbijetuar i trafikimit të qenieve njerëzore, apo formave të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, statusit të migrantës / migrantit, azilkërkueses / azilkërkuetit, apo për shkak të të qenit “person nën mbrojtje ndërkombëtare” (pra me status refugjateje/refugjati, të përkohshëm dhe nën mbrojtje plotësuese), me status “pa shtetësi”, etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PLVBGJ 2024 - 2026, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit përkatës dhe dokumentet kryesore ku mbështeten hapat e planifikuar.

⁶ Në kuadër edhe të përafritimit të këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore me Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore – EU GAP III.

II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut sikurse Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (njohur si CEDAW), Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, apo Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (e njohur si Konventa e Stambollit), drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin vendor dhe në rast konflikti konsiderohet që këto konventa kanë prioritet ndaj akteve dhe ligjeve të nxjerra nga institucionet publike.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

Ligji për Barazi Gjinore, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.⁷

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026 i Komunës Istog, mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Kosovë. Si më kryesoret mund të përmendim:

1. Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa për të Drejtat Politike të Grave,
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore,
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve,
- Deklarata dhe Platforma për Veprimit e Pekinit,
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje,
- Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë,
- Agjenda e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm, 2030,
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020 - 2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021 - 2025,
- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

2. Korniza ligjore dhe zhvillimore kombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7, 21 dhe 22,
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040,
- Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020,
- Ligji për Trashëgimi Nr.2004/26,
- Ligji Nr. 06/L-077 Për ndryshim- plotësimin e Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen,
- Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi Nr.05/L-021,
- Ligji për Pronat dhe të Drejtat Pronësore Nr.03/L-154,
- Ligji i Punës Nr. 03/L-212,

⁷ Shih PKBGJ, fq. 11

- Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore Nr. 08/L-185,
- Ligji Nr.04/l-81 Për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-17,
- Ligji Nr.2011/04-L-096 Për ndryshim- plotësimin e Ligjit të Skemës së Ndhimave Sociale Nr.2003/15,
- Ligji Nr. 03/L022 Për Mbështetje Materiale të Familjeve me Fëmijë me Aftësi të kufizuar Përhershme,
- Ligji Nr. 08/L-109 Për Kompensimin e Viktimave të Krimin,
- Ligji Nr. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijës,
- Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi,
- Ligji Nr. 06/L-026 Për Azil,
- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 - 2024,
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim,
- Programi i Reformave Ekonomike,
- Strategjia për Rregullim më të Mirë,
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave,
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit,
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat Pronësore,
- Rregullorja për banim social,
- Plani i Veprimit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2024-2026, i Ministrisë së Shëndetësisë, etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PLVBGJ 2024 - 2026 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët e caktuar sipas fushave të tyre.

Përgjegjëse kryesore për zbatimin e PLVBGJ mbetet **Komuna**. Kjo nënkupton përgjegjësi si për zbatim të drejtpërdrejtë të masave dhe veprimeve të parashikuara, ashtu edhe për koordinimin me institucionet dhe aktorët përkatës, që bëjnë të mundur zbatimin e këtyre masave dhe veprimeve. Pra nëse komuna nuk ka mundësi financiare, njerëzore apo infrastrukturore që të zbatojë drejtpërdrejt një masë apo veprim të caktuar, përgjegjësia e saj është të koordinohet dhe të bashkërendojë veprimet me atë institucion që e ka këtë mundësi, duke përfshirë edhe OJQ, institucionet private, organizatat ndërkombëtare, etj. Zyrtarja për Barazi Gjinore dhe për Mbrojtje nga Diskriminimi (ZBGJMD) do të mbetet përgjegjëse për koordinimin dhe zbatimin e një sërë masash dhe veprimesh të parashikuara në PLVBGJ, por, tashmë ky është një plan i të gjithë komunës ndaj dhe përgjegjësia kryesore për këtë plan në tërësi jo domosdoshmërisht bie mbi ZBGJMD. Gjithashtu, PLVBGJ 2024 - 2026, i zberthyer vit pas viti, zëvendëson edhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore që ZBGJMD përgatiste dhe paraqiste përpara Kryetarit të Komunës dhe Agjencisë për Barazi Gjinore, në mënyrë të përvitshme.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin lokal luan edhe Grupi Jo Formal i Grave Asambleiste, të cilat gjithashtu kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për hartimin e këtij Plani. Në vijim, të gjitha institucionet lokale dhe OJQ të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PLVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PLVBGJ.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore, është:

- një **mjet praktik i lokalizimit të dokumenteve të rëndësishëm kombëtarë, por edhe ndërkombëtarë në lidhje me barazinë gjinore** (veçanërisht instrumentet drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit).
- një **dokument i hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës**, me hapa të mirë përcaktuar, e **në përmbajtje të të cilit reflektohen arritjet dhe sfidat** e ndeshura ndër vite nga Komuna, në **përparimin drejt barazisë gjinore**.

- një **pasqyrim i qartë i roleve dhe përgjegjësi të domosdoshme** për t'u përmbushur brenda Komunës, si dhe ndërmjet Komunës e institucioneve lokale apo organizatave të shoqërisë civile e ato ndërkombëtare, me qëllim **zbatimin në praktikë të parimit të barazisë për të gjitha/gjithë gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë**, në të gjithë diversitetin e tyre, në Komunën e Istogut.

III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PLVBGJ 2024 - 2026 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- ✓ **Ngritja e Grupit Punues për përgatitjen e këtij plani, me Vendim të Kryetarit të Komunës.** Grupi Punues për përgatitjen e këtij PLVBGJ u ngrit me Vendim të Kryetarit Nr.Br.01-181/2024 të datës 12.04.2024 dhe kishte në përbërje të tij 13 zyrtare / zyrtarë, konkretisht:
 - Z. Arben Kabashi, Kryesues,
 - Z. Genc Ademaj, Anëtar,
 - Znj. Arlinda Kurtaj, Anëtare,
 - Znj. Zekije Sutaj, Anëtare,
 - Z. Brahim Hetemaj, Anëtar,
 - Z. Fadil Kabashi, Anëtar
 - Znj. Servete Haxhiaj, Anëtare,
 - Z. Xhevdet Zekaj, Anëtar,
 - Znj. Vlora Gjoci, Anëtare,
 - Z. Drin Sadikaj, Anëtar,
 - Znj. Valbone Demaj, Anëtare,
 - Z. Ardon Arifaj, Anëtar,
 - Z. Blerim Gerguri, Anëtar.
- ✓ **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues.** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues të komunës, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kornizës ligjore dhe të politikave ekzistuese kombëtare e lokale, të lidhura me çështjet gjinore.
- ✓ **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes,** të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PLVBGJ 2024 - 2026. Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, si vlerësimi i arritjeve dhe sfidave të komunës për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore, identifikimi i prioritetëve bazuar në analizën e cekur më sipër, marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të dala nga diskutimet me stafin e komunës, etj.).
- ✓ **Konsultimet paraprake brenda komunës dhe hartimi i draft PLVBGJ.** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e komunës si dhe në veçanti me anëtarët / anëtarët e Grupit Punues dhe me Grupin Jo Formal të Grave Asambleiste. Që prej fillimit të këtyre konsultimeve u prezantuan instrumente kryesore të rëndësishme ndërkombëtare, sidomos ato të BE-së të lidhura me barazinë gjinore (si për shembull Plani i Veprimit i BE-së për Barazinë Gjinore / EU GAP III, apo Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.). Po kështu u prezantuan edhe prioritetet e cekura në dokumente të rëndësishme kombëtare si Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 - 2024, Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III, 2021 – 2025, etj. Më pas u kalua në përgatitjen e draft matricës së PLVBGJ-së, e cila përmbante objektivat strategjike, rezultatet e pritshme, dokumentet se ku referoheshin masat dhe veprimet e parashikuara, objektivat specifikë, treguesit në nivel objektiv, së bashku me vlerën bazë (e matur për vitin 2023 ose që do përcaktohet gjatë vitit 2024) dhe vlerën e synuar (target) deri në vitin 2026, rezultatit në nivel të objektivit specifik, si dhe aktivitetet, drejtorinë përgjegjëse për zbatim, partnerët dhe bashkëpunëtorët, afatin kohor, koston për tre vitet, burimin e financimit, treguesit për çdo aktivitet, si dhe përgjegjësit për monitorimin e zbatimit të PLVBGJ.

- ✓ **Postimi në faqen e Komunës për komente dhe sugjerime nga individët dhe grupet e interesit.** Draft PLVBGJ 2024 - 2026 u postua në datën 02.05.2024 në linkun <https://kk.rks.gov.net/istog/category/konsultimetpublike/> Postimi qëndroi i hapur për komente dhe sugjerime deri në datën 16.05.2024, duke plotësuar kështu detyrimin për konsultimin publik, në mbështetje të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Nr.03L-040 dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.
- ✓ **Mbajtja e konsultimit publik me banoret dhe banorët e Komunës.** Në përputhje dhe vijim të sa cekur më sipër, Komuna e Istogut mbajti edhe sesionin e dëgjimit publik në datën 16.05.2024, në ora 11:00.
- ✓ **Përmirësimi i draft PLVBGJ-së.** Pas seancës së dëgjimit publik dhe në përfundim të të gjithë procesit të konsultimit publik, Grupi Punues bëri edhe përmirësimin e draft PLVBGJ, bazuar në të gjitha komentet dhe sugjerimet e marra.
- ✓ **Kostimi i matricës së PLVBGJ.** Procesi i kostimit të matricës së PLVBGJ ishte një proces tepër i rëndësishëm që gjithashtu mori kohën e tij për gjatë përgatitjes së dokumentit të plotë. Kostimi u krye për secilin nga aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ-së dhe fondet u ndanë sipas burimit të financimit, konkretisht fonde të mbuluara nga komuna, me burime ekzistuese njerëzore, infrastrukturore apo financiare, fonde të mbuluara nga donatorët, por edhe fonde për gjetjen e të cilave duhet të bëhen rishikime dhe planifikime në buxhetet përkatëse të viteve të ardhshme, ose duhet të llobohet për t'i siguruar përmes bashkëpunimit me donatorët, subjektet private e OJQ-të (pra hendeku financiar).
- ✓ **Dorëzimi i dokumentit të plotë, të kostuar e përfunduar, për miratim në Kuvendin Komunal.** Pas përgatitjes dhe përfundimit të të gjithë procesit, dokumenti i plotë i PLVBGJ, edhe i kostuar, u dorëzua për miratim në Kuvendin Komunal, duke ndjekur të gjitha hapat, detyrimet dhe afatet ligjore përkatëse.
- ✓ **Miratimi i PLVBGJ në Kuvendin Komunal.** PLVBGJ u miratua në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal në xxxx 2024.

Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë jo vetëm me detyrimet kombëtare, por edhe me metodologjinë e përgatitjes së PLVBGJ-ve siç sugjerohet nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).⁸

Një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e përgatitjes deri në finalizimin e PLVBGJ ka luajtur mbështetja dhe asistencë teknike e ofruar nga UN Women Kosovë, përmes një ekipi të mirë përgatitur si dhe një konsulenteje⁹ të angazhuar për këtë qëllim, në kuadër të zbatimit të Projektit “Gender Equality Facility” (GEF) që financohet nga Bashkimi Evropian.

IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Vizioni i PLVBGJ-së adreson:

“Një qeverisje të mirë, gjithëpërfshirëse e të drejtë gjinore, ku gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Istogut, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të migrantëve/migrantit e azilkërkuarës/azilkërkuarës, statusit të “personit nën mbrojtje ndërkombëtare” (me status refugjateje/refugjati, të përkohshëm dhe nën mbrojtje plotësuese), statusit “pa shtetësi”, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale,

⁸ Për më shumë shikoni në: <https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html>

⁹ Znj. Monika Kocaqi, konsulente ndërkombëtare.

gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

Parimet¹⁰ që udhëheqin zbatimin e PLVBGJ, mbështeten kryesisht në parimet që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, siç paraqiten në vijim:

1. **Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore.** Kjo e drejtë duhet të zbatohet nga organet e vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat e tyre të përgjegjësisë; ajo përfshin gjithashtu edhe detyrimin për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit, të drejtpërdrejta apo të tërthorta.
2. **Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.** Përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore duhet të marrin parasysh dhe të trajtojnë – nga një këndvështrim gjithëpërfshirës, sistemik dhe strukturor – mënyrat se si ndërvepron gjinia me faktorë të tjerë si seksi, raca, ngjyra e lëkurës, origjina etnike ose sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionet politike dhe çfarëdo opinionesh të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, origjina në lindje, aftësitë e kufizuara, mosha, ose orientimi seksual.
3. **Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike.** E drejta për barazi të grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, kërkon që organet vetëqeverisëse lokale të marrin të gjitha masat e duhura dhe të miratojnë të gjitha strategjitë e përshtatshme për promovimin e përfundimit dhe të pjesëmarrjes së balancuar në të gjitha sferat e vendimmarrjes.
4. **Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.** Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të nxisin punën për eliminimin e stereotipeve dhe pengesave që krijojnë pabarazi në statusin dhe gjendjen e grave / të rejave / vajzave dhe që janë burimi i vlerësimit të pabarabartë të roleve të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve nga pikëpamja politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.
5. **Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes lokale është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.** Perspektiva gjinore duhet të mbahet parasysh gjatë hartimit të politikave, metodave dhe instrumenteve që ndikojnë në jetën e përditshme të popullsisë lokale – për shembull përmes përdorimit të teknikave të “vlerësimeve gjinore”, “auditimit gjinor”, “integritimit gjinor”, dhe të “buxhetimit të përgjegjshëm gjinor”. Për arritjen e këtij synimi duhet të analizohen dhe të merren parasysh përvojat e shumta dhe të gjera të grupeve të ndryshme të grave në jetën lokale, si edhe kushtet e jetesës dhe të punës së tyre.
6. **Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.** Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të hartojnë plane dhe programe veprimi për barazinë gjinore, të mbështetura me burimet financiare e njerëzore të nevojshme për zbatimin e tyre.

Objektivat strategjikë të PLVBGJ.

PLVBGJ 2024 - 2026 përbëhet nga katër objektiva strategjike, të cilat janë harmonizuar edhe me:

- Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore,
- Programin e Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024,
- Planin e Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën të Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025,
- Konventën për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),

¹⁰ Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

- Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit),
- Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BDPFA),
- Agjendën 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030,
- Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III),
- Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

Katër objektivat strategjike të PLVBGJ 2024 - 2026 të Komunës së Istogut, renditen në vijim:

1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
2. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, për gratë, të rejat dhe vajzat.
3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për gratë dhe burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.
4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

Secila nga këto objektiva strategjike është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PLVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera lokale, organizatat e shoqërisë civile, institucionet private, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparencja e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PLVBGJ.

Rezultatet e pritshme, objektivat specifike dhe treguesit

<p>Objektivi strategjik:</p> <p>1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>1.a. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, e përmirësuar.</p> <p>1.b. Planet e zhvillimit dhe ndërhyrjes në të gjitha fushat, si dhe programet buxhetore të Komunës, me perspektivën gjinore të integruar.</p>
<p>Objektivat specifike:</p> <p>1.1. Krijimi i mundësive të barabarta dhe rritja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, duke luftuar stereotipet gjinore, diskriminimin dhe disavantazhimin e shumëfishtë.</p> <p>1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.</p>
<p>Treguesit në nivel objektivi:</p> <p>1.1.a. Numri i grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, të informuara mbi të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike.</p> <p>1.2.a. Përqindja e buxhetit komunal dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.</p>
<p>Objektivi strategjik:</p> <p>2. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, për gratë, të rejat dhe vajzat.</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p>

<p>2.a. Pjesëmarrja e grave dhe të rejave në aplikimin dhe përfitimin e subvencioneve të komunës në lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin rural, e përmirësuar ndjeshëm.</p> <p>2.b. Numri i të rejave dhe grave në punësim dhe ndërmarrësi, i rritur si rrjedhojë e veprimeve mbështetëse dhe inkurajuese të komunës.</p>
<p>Objektivat specifikë:</p> <p>2.1. Rritja e qasjes së të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime, burime dhe produkte financiare, duke synuar fuqizimin ekonomik, veçanërisht në bujqësi.</p> <p>2.2. Rritja e vetëdijesimit dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet e kujdesit, duke mundësuar ndarje të barabartë të punës shtëpiake dhe të kujdesit midis grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve.</p>
<p>Treguesit në nivel objektiv:</p> <p>2.1.a. Përqindja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, që mbështeten me subvencione në fushën e bujqësisë.</p> <p>2.2.a. Numri i banoreve / banorëve të informuar për ndarje të barabartë të punës shtëpiake dhe të kujdesit midis grave / të rejave / vajzave dhe burrave / të rinjve / djemve.</p>
<p>Objektivi strategjik:</p> <p>3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>3.a. Qasja e grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, e përmirësuar ndjeshëm.</p> <p>3.b. Më shumë vajza, të reja dhe gra të Komunës, të angazhuara në aktivitete sportive e kulturore.</p>
<p>Objektivat specifikë:</p> <p>3.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejtat, gratë dhe djemtë, të rinjtë, burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre.</p> <p>3.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport.</p>
<p>Treguesit në nivel objektiv:</p> <p>3.1.a. Numri i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përfshira në shërbime cilësore të arsimit.</p> <p>3.2.a. Numri i grave, të rejave dhe vajzave në art, kulturë e sporte, si dhe numri i klubeve sportive të tyre, që mbështeten me subvencione në mënyrë të përvitshme.</p>
<p>Objektivi strategjik:</p> <p>4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>4.a. Edukimi mbi shëndetin seksual e riprodhues mes profesionisteve/profesionistëve dhe në komunitet, merr rëndësi të veçantë.</p> <p>4.b. Vendimmarrja tek vajzat, djemtë, të rejtat, të rinjtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm.</p>
<p>Objektivi specifik:</p> <p>4.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.</p>
<p>Tregues në nivel objektiv:</p> <p>4.1.a. Numri i grave, të rejave, vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, me akses të shtuar në kujdesin dhe shërbimet shëndetësore seksuale dhe riprodhuese.</p>

V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ 2024 - 2026

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ 2024 - 2026 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zërthehet më tej në kosto që mbulohe nga vetë Komuna (si me burimet ekzistuese njerëzore, financiare e infrastrukturore, ashtu edhe me burime që duhet të shtojë), kosto që mbulohe nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse një pjesë të mirë të aktiviteteve Komuna e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra zyrtareve / zyrtarëve, të cilat/cilët aktualisht marrin një pagë fikse, sallave/ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin, etj.), në këtë Plan Lokal Veprimi për Barazinë Gjinore 2024 - 2026 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës. Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PLVBGJ nuk merr jetë, Komuna duhet të përfshijë në kornizën e parashikimeve buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në këtë PLVBGJ. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë Grupi Jo Formal i Grave Asambleiste për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve/masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Komunës, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Lokal të Veprimit, **duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara**, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo KAB-et e Komunës, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së KAB-eve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PLVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PLVBGJ 2024 - 2026 janë në vlerën **1,003,402 EUR**. Nga këto:

- **105,167 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
- **226,130 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 2. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, për gratë, të rejat dhe vajzat.
- **619,269 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për gratë dhe burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre
- **52,836 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

Në totalin e koston **1,003,402 EUR** të nevojshme për zbatimin në tërësi të PLVBGJ 2024 - 2026 për të gjithë kohëzgjatjen e tij (tre vite):

- **943,540 EUR janë kosto që do të mbulohen nga Komuna** (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete, etj.), pra **të cilat nuk kanë nevojë të përllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukurore ekzistojnë. Këtu përfshihen edhe grante apo subvencionime të planifikuara për fusha të caktuara dhe për banoret dhe banorët në të gjithë diversitetin e tyre dhe vit pas viti do maten se sa kanë përfituar gratë, të rejat dhe vajzat në veçanti.**
- **6,780 EUR janë kosto që mbulohen nga donatorë** të ndryshëm (të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PLVBGJ-së).
- **53,082 EUR (ose 5.3% e totalit të buxhetit të tre viteve) janë hendek financiar**, për të cilat komuna do të llojë për gjetjen e burimeve financuese, ose do të bëjë planifikimet e saj shtesë në KAB-et e ardhshme, duke filluar nga KAB 2025 - 2027.

Objektivat strategjikë	Objektivat specifikë	Gjithsej kosto për tre vjet	Komuna	Donatorë të konfirmuar	Hendek financiar
------------------------	----------------------	-----------------------------	--------	------------------------	------------------

1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.	1.1. Krijimi i mundësive të barabarta dhe rritja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, duke luftuar stereotipet gjinore, diskriminimin dhe disavantazhimin e shumëfishhtë.	35,706 EUR	24,822 EUR	480 EUR	10,404 EUR
	1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunes që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.	69,461 EUR	51,387 EUR	2,010 EUR	16,064 EUR
Gjithsej Objektiv i strategjik 1:		105,167 EUR	76,209 EUR	2,490 EUR	26,468 EUR
2. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, për gratë, të rejtat dhe vajzat	2.1. Rritja e qasjes së të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime, burime dhe produkte financiare, duke synuar fuqizimin ekonomik, veçanërisht në bujqësi.	186,715 EUR	182,065 EUR	3,990 EUR	660 EUR
	2.2. Rritja e vetëdijesimit dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet e kujdesit, duke mundësuar ndarje të barabartë të punës shtëpiake dhe të kujdesit midis grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve.	39,415 EUR	38,215 EUR	0 EUR	1,200 EUR

Gjithsej Objektivi strategjik 2:		226,130 EUR	220,280 EUR	3,990 EUR	1,860 EUR
3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për gratë dhe burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.	3.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejtat, gratë dhe djemtë, të rinjtë, burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre.	58,791 EUR	47,601 EUR	300 EUR	10,890 EUR
	3.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport.	560,478 EUR	557,714 EUR	0 EUR	2,764 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 3:		619,269 EUR	605,315 EUR	300 EUR	13,654 EUR
4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.	4.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.	52,836 EUR	41,736 EUR	0 EUR	11,100 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 4:		52,836 EUR	41,736 EUR	0 EUR	11,100 EUR

Për më shumë detaje, lutemi referohuni tek Matrica e Planit Lokal të Veprimit në vijim.

VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria / Zyra / Njësia përgjegjëse për zbatimin e aktivitetit tek **Zyra e Kryetarit**.

Menjëherë pas miratimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026, si hap i parë i zbatimit të tij, do të mblidhen të dhënat për vlerën bazë të treguesve në nivel të objektivave specifike. Po kështu do të hartohen edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mblidhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike. **Raportimet në bazë të objektivave specifike** do të përgatiten **dy herë në vit (çdo 6 muaj)** ose në bazë të kërkesës së Zyrës së Kryetarit.

Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit **në nivel të objektivave** do të kryhet nga **Zyra e Kryetarit**, i cili, në bazë të kompetencave të tij mund të vendosë edhe për themelimin e një trupe me

Gjithashtu, me vendim të Kryetarit të komunës, do të themelohet edhe një **Grup Monitorues i objektivave specifike të këtij Plani Lokal Veprimi për Barazinë Gjinore**. Ky Grup Monitorues do të përbëhet nga zyrtarë dhe zyrtarë të Komunës, të cilat / cilët e njohin mirë jo vetëm përmbajtjen e PLVBGJ, por kanë edhe kompetencën dhe profesionalizmin që të bëjnë monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të aktiviteteve të PLVBGJ, si dhe të vlerësojnë se deri në çfarë mase janë arritur të realizohen objektivat specifike. Ky Grup Monitorues do të mbajë përgjegjësi edhe për llogaridhënien e vazhdueshme në lidhje me zbatimin e PLVBGJ, si dhe për rishikimin e përditësimin e këtij plani.

Raportet monitorimit të përgatitura nga Grupi Monitorues, do të përcillen edhe tek Grupi Jo Formal i Grave Asambleiste dhe Komiteti për Barazi Gjinore, si dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në Agjencinë për Barazi Gjinore, apo në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Bazuar në monitorimin e kryer, PLVBGJ **duhet të rishikohet dhe përmirësohet** në mënyrë periodike dhe të paktën çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 - 2026

OBJEKTIVI STRATEGJIK:	1. PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE, TË REJAVE DHE VAJZAVE NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE.								
Rezultatet e pritshme:	1.a. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, e përmirësuar. 1.b. Planet e zhvillimit dhe ndërhyrjes në të gjitha fushat, si dhe programet buxhetore të Komunës, me perspektivën gjinore të integruar.								
Referenca në dokumentet kryesore:	- Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, nenet 1, 2, 4, 5, 6, 12. - Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 1, objektivi specifik 1.2, objektivi strategjik 3, objektivat specifike 3.1 dhe 3.2. - Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 1, objektivat specifike 3.2 dhe 3.7, fusha tematike 4, objektivat specifike 4.1, 4.2 dhe 4.4. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5 dhe 7. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA), fushat kritike 7, 8 dhe 9. - Agjenda 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 5, target 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.a dhe 5.c, treguesit 5.1.1, 5.2.1, 5.2.2, 5.3.1, 5.4.1, 5.5.1, 5.5.2, 5.a.1, 5.a.2 dhe 5.c.1; SDG 16, target 16.7 dhe 16.b, treguesit 16.7.1, 16.7.2 dhe 16.b.1 - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fusha tematike 4. - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.								
Objektivi specifik:	1.1. Krijimi i mundësive të barabarta dhe rritja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, duke luftuar stereotipet gjinore, diskriminimin dhe disavantazhimin e shumëfishtë.								
Treguesi	Vlera bazë (2024)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati						
1.1.a. Numri i grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, të informuara mbi të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike.	Do përcaktohet	Rritur me 10%	Më shumë vajza, të reja e gra, në të gjithë diversitetin e tyre, informohen e vetëdijesohen për të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike.						
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)			BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ institucionet mbështetëse		2024	2025	2026			
1.1.1. Takime vetëdijesuese me gratë dhe të reja, mbi rëndësinë e barazisë në pjesëmarrje dhe leadership, në vendimmarrjen politike e publike dhe	Zyrtarja për Barazi Gjinore dhe Mbrojtjen nga	Sektori për të Drejta të Njeriut dhe	2024 - 2026	1,605 € (nga të cilat 915 € komuna	1,605 € (nga të cilat 915 € komuna	1,605 € (nga të cilat 915 € komuna dhe	SDNJK DAK	- 9 takime të zhvilluara (3 në vit)	Zyra e Kryetarit (ZK)

<p>nxitjen e tyre për të marrë pjesë në Këshillat Lokalë.</p>	<p>Diskriminimi (ZBGJMD)</p>	<p>Komunitete (SDNJK)</p> <p>Drejtoria për Administratë Komunale (DAK)</p> <p>Drejtoria Komunale për Arsim (DKA)</p> <p>Grupi Jo Formal i Grave Asambleiste (GGA)</p> <p>Organizata Jo Qeveritare (OJQ)</p> <p>Organizata Ndërkombëtare (ON)</p>		<p>dhe 690 € hendek financiar)</p>	<p>dhe 690 € hendek financiar)</p>	<p>690 € hendek financiar)</p>	<p>DKA</p> <p>Donatorët</p>	<p>- 180 gra të informuara (60 në vit) ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, etj.</p>	<p>Grupi Monitorues (GM)</p>
<p>1.1.2. Aktivitete informuese në kuadër të javës së “8 Marsit – Dita Ndërkombëtare e Gruas”.</p>	<p>ZBGJMD</p>	<p>SDNJK</p> <p>DAK</p> <p>GGA</p> <p>OJQ</p> <p>ON</p>	<p>2024 - 2026</p>	<p>788 €</p> <p>(nga të cilat 398 € komuna dhe 390 € hendek financiar)</p>	<p>788 €</p> <p>(nga të cilat 398 € komuna dhe 390 € hendek financiar)</p>	<p>788 €</p> <p>(nga të cilat 398 € komuna dhe 390 € hendek financiar)</p>	<p>SDNJK</p> <p>Donatorët</p>	<p>- 3 takime të zhvilluara (1 në vit)</p> <p>- 60 gra të informuara (20 në vit) ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, etj.</p>	<p>ZK</p> <p>GM</p>

1.1.3. Aktivitete vetëdijesuese për shënimin e ditës botërore kundër punës së fëmijëve vajza dhe djem (12 Qershori).	SDNJK	ZBGJMD DKA OJQ ON	2024 - 2026	209 € (komuna)	209 € (komuna)	209 € (komuna)	SDNJK Donatorët	- 3 takime të zhvilluara (1 në vit) - 90 persona të informuar (30 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	ZK GM
1.1.4. Aktivitete informuese në kuadër të Fushatës së “16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”, me fokus femicidin, dhunën kibernetike, etj. ¹¹	ZBGJMD	Qendra për Punë Sociale (QPS) DA OJQ ON	2024 - 2026	2,106 € (nga të cilat 966 € komuna dhe 1,140 € hendek financiar)	2,106 € (nga të cilat 966 € komuna dhe 1,140 € hendek financiar)	2,106 € (nga të cilat 966 € komuna dhe 1,140 € hendek financiar)	SDNJK Donatorët	- 9 aktivitete të zhvilluara (3 në vit) - 180 gra të informuara (60 në vit) ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	ZK GM
1.1.5. Aktivitete vetëdijesuese për publikun e gjerë (gra dhe burra), mbi të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga diskriminimi gjinor dhe i shumëfishtë.	ZBGJMD	QPS DKA OJQ ON	2024 - 2026	948 € (nga të cilat 368 € komuna dhe 580 € hendek financiar)	948 € (nga të cilat 368 € komuna dhe 580 € hendek financiar)	948 € (nga të cilat 368 € komuna dhe 580 € hendek financiar)	SDNJK DKA Donatorët	- 3 takime të zhvilluara (1 në vit) - 120 gra dhe burra të informuara (40 në vit) ndarë sipas moshës, etnisë,	ZK GM

¹¹ Këto aktivitete janë në mbështetje të zbatimit të Planit Komunal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024 - 2026.

								vendbanimit, etj.	
1.1.6. Takime me të punësuarat / punësuarit në institucione lokale dhe diskutimi mbi rëndësinë e njohjes dhe raportimit të ngacmimeve seksuale në vendin e punës.	Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (NJMBNJ)	Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) ZBGJMD OJQ ON	2024 - 2026	980 € (nga të cilat 632 € komuna dhe 348 € hendek financiar)	980 € (nga të cilat 632 € komuna dhe 348 € hendek financiar)	980 € (nga të cilat 632 € komuna dhe 348 € hendek financiar)	ZK SDNJK Donatorët	- 6 takime të zhvilluara (2 në vit). - 180 persona të informuar (60 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj.	ZK GM
1.1.7. Trajnimi i zyrtares/zyrtarit për informim, përkthyesve/përkthyesve dhe zyrtareve/zyrtarëve të tjerë të komunës, për përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore.	SDNJK	OJQ ON	2024	766 € (nga të cilat 286 € komuna dhe 480 € donatori)	766 € (nga të cilat 286 € komuna dhe 480 € hendek financiar)	766 € (nga të cilat 286 € komuna dhe 480 € hendek financiar)	SDNJK Donatorët ¹²	- 3 trajnime të zhvilluar (1 në vit) - 45 zyrtare / zyrtarë të trajnuar (15 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, pozicionit të punës, etj.	ZK GM
1.1.8. Përfshirja e gjuhës në ndjeshme gjinore në dokumentet dhe publikimet që bën komuna.	Zyra për Informim (ZI)	ZBGJMD Të gjitha drejtoritë komunale që prodhojnë dokumente	2024 - 2026	4,500 € (komuna)	4,500 € (komuna)	4,500 € (komuna)	Drejtoritë komunale	- Numri i dokumenteve komunale ku aplikohet gjuha e ndjeshme gjinore	ZK GM
Objektivi specifik:	1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.								

¹² Për një trajnim do të japë mbështetje UN Women

Treguesi		Vlera bazë (2024)	Synimi i vitit të fundit (2026)	Rezultati					
1.2.a. Përqindja e buxhetit komunal dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.		Do përcaktohet	Rritur me 6%	Komuna do të hedhë hapa konkretë për integrimin gjinor në të gjithë fushat e veprimtarisë së saj, që do të realizohen duke përdorur si mjet kryesor buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.					
AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)			BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ institucionet mbështetëse		2024	2025	2026			
1.2.1. Themelimi dhe funksionalizimi i Grupit Monitorues të objektivave specifike të PLVBGJ.	SDNJK	ZL ZK	2024 - 2026	5,693 € (komuna)	11,815 € (nga të cilat 5,643 € komuna dhe 6,172 € hendek financiar)	11,815 € (nga të cilat 5,643 € komuna dhe 6,172 € hendek financiar)	ZK	- 1 vendim për themelimin e Grupit Monitorues - Lista e pjesëmarrjes në 4 takimet vjetore - Raportet e monitorimit të përpiluara sipas kërkesës (çdo 3 muaj, 6 muaj dhe vit)	ZK GM
1.2.2. Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve / zyrtarëve të komunës, për integrimin gjinor, vlerësimin e ndikimit gjinor në politika publike në nivel lokal.	ZBGJMD	ABGJ OJQ ON	2024 - 2026	766 € (nga të cilat 286 € komuna dhe 480 € donatori)	766 € (nga të cilat 286 € komuna dhe 480 € hendek financiar)	766 € (nga të cilat 286 € komuna dhe 480 € hendek financiar)	SDNJK Donatorët ¹³	- 3 trajnime të zhvilluar (1 në vit) - 45 persona të trajnuar (15 në vit), ndarë sipas	ZK GM

¹³ Për zbatimin e këtij aktiviteti do të ofrojë mbështetje edhe UN Women

								seksit, moshës, profesionit, etj.	
1.2.3. Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve / zyrtarëve të komunës, për aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.	ZBGJMD	ABGJ OJQ ON	2024 - 2026	766 € (nga të cilat 286 € komuna dhe 480 € donatori)	766 € (nga të cilat 286 € komuna dhe 480 € hendek financiar)	766 € (nga të cilat 286 € komuna dhe 480 € hendek financiar)	SDNJK Donatorët ¹⁴	- 3 trajnime të zhvilluar (1 në vit) - 45 persona të trajnuar (15 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj	ZK GM
1.2.4. Analiza gjinore dhe zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ) nga drejtoritë e komunës. ¹⁵	Drejtoria për Buxhet dhe Financë (DBF)	Drejtoritë komunale ZBGJMD OJQ ON	2024 - 2026	1,050 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 750 € donatori)	1,050 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 750 € hendek financiar)	1,050 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 750 € hendek financiar)	Drejtoritë komunale Donatorët	- Numri i programeve buxhetore ku aplikohet analiza gjinore dhe zbatohet BPGJ.	ZK GM
1.2.5. Përgatitja e formave të unifikuara për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit dhe karakteristikave të tjera, për të gjitha aktivitetet që organizon komuna.	Zyrtarja /zyrtari i Teknologjisë së Informacionit (ZTI)	ZBGJMD DKA OJQ ON	2024	800 € (nga të cilat 500 € komuna dhe 300 € donatori)	/	/	ZK Donatorët ¹⁶	- Format e unifikuara të përgatitura dhe shpërndara në çdo drejtori.	ZK GM
1.2.5. Përgatitja dhe përditësimi i një data baze me të gjitha të dhënat nga drejtoritë komunale të ndara sipas seksit dhe karakteristikave të tjera, për të gjitha aktivitetet që organizon komuna.	ZTI	DKA GM	2024 - 2026	6,972 € (nga të cilat 6,672 € komuna)	900 € (komuna)	900 € (komuna)	ZK	- Databaza e përgatitur dhe e përditësuar rregullisht	ZK GM

¹⁴ Për zbatimin e këtij aktiviteti do të ofrojë mbështetje edhe UN Women

¹⁵ Për zbatimin e këtij aktiviteti do të ofrojë mbështetje edhe UN Women

¹⁶ Për zbatimin e këtij aktiviteti do të ofrojë mbështetje edhe UN Women

				dhe 300 € hendek financiar)					
1.2.7. Takime për të nxitur pjesëmarrjen e grave / të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, në të gjitha dëgjimet publike, e veçanërisht në dëgjimet publike buxhetore.	DBF	ZBGJMD DAK OJQ ON	2024 - 2026	890 € (komuna)	890 € (komuna)	890 € (komuna)	DBF Donatorët	- 15 takime të zhvilluara (5 në vit) - 225 gra/të reja të informuara (75 në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	ZK GM
1.2.8. Mbledhja e të dhënave bazë për të gjithë treguesit në nivel objektiv specifik, të përcaktuar për matjen e progresit të këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ).	Secila drejtori përgjegjëse sipas treguesve të këtij PLVBGJ	ZBGJMD OJQ ON	2024	350 € (komuna)	/	/	Secila drejtori përgjegjëse sipas treguesve të këtij PLVBGJ	- Treguesit e plotësuar për çdo objektiv specifik të PLVBGJ	ZK GM
1.2.9. Shtimi në faqen zyrtare të internetit të Komunës, i një vegëze me informacione dedikuar çështjeve të Barazisë Gjinore dhe përditësimi rregullisht i saj.	ZTI	ZBGJMD ZI Drejtore komunale	2024 - 2026	3,950 € (komuna)	3,950 € (komuna)	3,950 € (komuna)	ZK	- Vegëza e shtuar - Informacioni i përditësuar rregullisht	ZK GM
1.2.10. Publikimi në faqen e komunës i gjetëve kryesore nga monitorimi i zbatimit të këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore.	ZTI	ZBGJMD Drejtore komunale	2024 - 2026	2,650 € (komuna)	2,650 € (komuna)	2,650 € (komuna)	ZK	- Linku me gjetjet e publikuara çdo vit	ZK GM
OBJEKTIVI STRATEGJIK:	2. FUQIZIMI EKONOMIK DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE TË PUNËSIMIT TË DENJË, PËR GRATË, TË REJAT DHE VAJZAT								
Rezultatet e pritshme:	1.a. Pjesëmarrja e grave dhe të rejave në aplikimin dhe përfitimin e subvencioneve të komunës në lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin rural, e përmirësuar ndjeshëm. 1.b. Numri i të rejave dhe grave në punësim dhe ndërmarrësi, i rritur si rrjedhojë e veprimeve mbështetëse dhe inkurajuese të komunës.								

Referenca në dokumentet kryesore:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, nenet 1, 2, 4, 5, 6, 12, 15, 16, 17 dhe 18. - Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 1, objektivat specifike 1.1 dhe 1.2. - Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 3, objektivi specifikë 2, 3, 4, 5 dhe 6. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5, 11, 13 dhe 14. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA), fushat kritike 1 dhe 6 - Agjenda 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 5, targets 5.1, 5.4 dhe 5.a, treguesit, 5.1.1, 5.4.1 dhe 5.a.1, SDG 8, targets 8.5 dhe 8.6, treguesit 8.5.2 dhe 8.6.1. - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fusha tematike 3. - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, nenet 10, 11, 15, 18, 27, 31, 34 dhe 35.
--	---

Objektivi specifik: *2.1. Rritja e qasjes së të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime, burime dhe produkte financiare, duke synuar fuqizimin ekonomik, veçanërisht në bujqësi.*

Treguesi	Vlera bazë (2024)	Synimi i vitit të fundit (2027)	Rezultati
2.1.a. Përqindja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, që mbështeten me subvencione në fushën e bujqësisë.	Do përcaktohet	Rritur me 6%	Gratë dhe të rejtat në zonat rurale do të nxiten dhe mbështeten që të përdorin të gjitha burimet dhe mjetet në dispozicion, për fuqizimin e tyre dhe zhvillimin e ekonomisë mjedisore të zonës. Ato do të pajisen me njohuritë e nevojshme për të aplikuar për subvencionet që komuna planifikon për bujqësisë. Përqindja e grave dhe të rejave të subvencionuara krahasuar me përqindjen e burrave dhe të rinjve, do të rritet vazhdimisht duke synuar plotësimin e detyrimit për trajtim të barabartë, në përputhje me ligjin për barazinë gjinore.

AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)			BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ zyrat mbështetëse							
2.1.1. Plotësim – ndryshimi i rregullores për ndarjen e granteve dhe subvencioneve ku të vendosen masa afirmative që u japin përparësi dhe nxitin mbështetjen e gjinisë më pak të përfaqësuar në bujqësi, ndërmarrësi	Zyra Ligjore (ZL)	ZK Drejtoria për Bujqësi, Hidroekonomi	2024	814 € (komuna)	/	/	ZK DBHP	- Rregullorja e plotësuar-ndryshuar dhe miratuar	ZK GM

		dhe Pylltari (DBHP) Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim (DEZH)							
2.1.2. Sensibilizimi i grave për mundësitë e përfitimit nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.	DBHP	ZBGJMD SDNJK OJQ ON	2024 - 2026	564 € (nga të cilat 344 € komuna dhe 220 € hendek financiar)	564 € (nga të cilat 344 € komuna dhe 220 € hendek financiar)	564 € (nga të cilat 344 € komuna dhe 220 € hendek financiar)	DBHP SDNJK Donatorët	- 3 takime informuese të zhvilluara (1 në vit) - 54 gra të informuara (18 në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, etj.	ZK GM
2.1.3. Mbështetja financiare e fermereve dhe fermerëve në mekanizimin dhe mjete të tjera të punës për prodhimtari bujqësore	DBHP	MBZHR ZK OJQ ON	2024 - 2026	20,500 € (komuna)	60,500 € (komuna)	65,000 € (komuna)	DBHP Donatorët	- 90 fermere të mbështetura financiarisht (30 në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	ZK GM
2.1.4. Ngritja e kapaciteteve të fermereve dhe fermerëve përmes trajnimeve në çështje të ndryshme të bujqësisë	DBHP	MBZHR OJQ ON	2025 - 2026	1,990 € (nga të cilat 1,240 € komuna dhe 750 € donatori ¹⁷)	1,990 € (nga të cilat 1,240 € komuna)	1,990 € (nga të cilat 1,240 € komuna)	DBHP MBZHR Donatorët	- 15 trajnime të zhvilluara (5 në vit) - 225 persona të trajnuar (75	ZK GM

¹⁷ Ekspert/ja nga MBZHR

					dhe 750 € donatori ¹⁸⁾	dhe 750 € donatori ¹⁹⁾		në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	
